



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 7, QARKU SHKODËR,
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2017**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 15.05.2019 me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.7, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1, e ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 1559 prot., datë 20.03.00.2019, i është drejtuar Prefektit të Qarku Shkodër, duke kërkuar paraqitjen e listës së plotë të objekteve brenda territorit të Qarkut Shkodër që përmbushin kriteret e neneve 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015, për caktimin e Vendeve të Numërimit të Votave, për tetë (8) Zonat e Administrimit Zgjedhor.

Prefekti i Qarkut Shkodër, me shkresën nr. 2590 prot, datë 30.04.2019, i ka paraqitur KQZ-së propozimet për ambiente të cilat mund të shërbejnë si Vende të Numërimit të Votave për secilën nga VNV-të e Qarkut Shkodër.

Ambienti i propozuar për krijimin e VNV-së për ZAZ-në Nr.7, Qarku Shkodër, është:



Nr. 375 i Vendimit Data 15.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.07, Qarku Shkodër,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

1. Pallati i Sportit (struktura sportive) pranë Shkollës së Mesme "Sabah Sinani", me sipërfaqe rreth 759 m², Bashkia Pukë;

Ky ambient propozohet për herë të parë për caktimin e VNV. Ndërtesë e rikonstruktuar pranë Shkollës së Mesme "Sabah Sinani" në Bashkinë Pukë. VNV për zgjedhjet e 2017 ka qënë palestra e Shkollës 9-vjeçare "Migjeni" me sipërfaqe 300 m². Ambienti i propozuar ka sipërfaqe dhe kushte më optimale në raport me ambientin që ka shërbyer si VNV në zgjedhjet e 2017.

Ambienti i propozuar ndodhet brenda territorit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor si dhe të Udhëzimit nr. 4, datë 9.04.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për mënyrën e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupeve të numërimit".

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr.7, Qarku Shkodër, në Pallatin e Sportit (struktura sportive) pranë Shkollës së Mesme "Sabah Sinani", me sipërfaqe rreth 759 m², Bashkia Pukë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 375 i Vendimit Data 15.05.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të ZAZ-së Nr.07, Qarku Shkodër,
për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019